




# Kosova dhuron 2023

## RAPORT MBI GJENDJEN E FILANTROPISË

# SI KONTRIBUON KOSOVA NË EDUKIM?


Edukimi ka qenë një nga kauzat më të shpeshta të dhurimit në filantropinë kosovare gjatë viteve të fundit, por pasi arriti nivelin më të lartë të dhurimit në vitin 2020, dhurimet për edukim kanë shënuar rënie në popullaritet. Në vitin 2023, trendi i dhurimeve për edukim u rikthye me një rritje si në përqindjen e shumave të dhuruara ashtu edhe në rastet e filantropisë të drejtuara për edukim, krahasuar me vitin paraprak.

### Trendet e dhurimeve për edukimin në Kosovë (2019-2023)




### Kontribuuesit kryesorë për edukimin në Kosovë

Dhuruesit individualë kanë qenë shtytësit kryesorë të rritjes së dhurimeve për edukimin në Kosovë në vitin 2023, duke përfaqësuar kategorinë më të theksuar të donatorëve për nga numri i rasteve të kontributeve.



### Kosova 2023 – Përfituesit e dhurimeve për edukim

Shumica e dhurimeve për edukim në Kosovë ishin drejtuar për fondet e bursave – me përfituesit kryesorë që ishin fëmijët dhe të rinjtë nga komunitetet lokale, si dhe përfituesit e bursave që ndjeknin studimet jashtë vendit.



Dhurimi më i madh individual për edukimin në vitin 2023 ishte ngjarja e mbledhjes së fondeve “Përkrah Rrëfimin e Ardhshëm të Suksesit,” e organizuar në Prishtinë nga RIT Kosova (A.U.K), e cila arriti të grumbullojë me sukses 130,000 euro për fondin e bursave për studentë përmes kontributeve masive individuale.



Financimi për arsimin fillor mori vëmendje të konsiderueshme në vitin 2023, me 70 raste të dhurimit krahasuar me 16 raste për arsimin e lartë. Nga ana tjetër, dhurimet për arsimin e lartë grumbulluan pothuajse 50,000 euro më shumë fonde.

Dëshironi të dini më shumë? Informacione shtesë për dhurimet për edukim në Kosovë në vitin 2023 mund të gjeni në [këtë link](#).



Burimi: [kosovadhuron.org](https://kosovadhuron.org)



Kjo infografikë është bërë e mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Catalyst Balkans dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).